


Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 14.11.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2464/17, për zyrtaren e lartë znj. Arta Agani, Drejtoresh e Galerisë Kombëtare të Arteve të Kosovës, për shkak se zyrtarja e lartë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik .

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-2464/17, që për trajtim ka pasur zyrtaren e lartë znj. Arta Agani, Drejtoresh e Galerisë Kombëtare të Arteve të Kosovës.

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit, është vërejtur se zyrtarja e lartë znj. Arta Agani, Drejtoresh e Galerisë Kombëtare të Arteve të Kosovës, figuron si person i autorizuar në një biznese private e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtaren e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese znj. Arta Agani, ka ardhur në takim ne zyrat e AKK-së dhe nga zyrtarët e AKK-së, është njoftuar me faktet që posedon Agjencia lidhur me rastin e iniciuar për të.

Ne këtë takim znj. Agani, i janë prezantuar dëshmitë lidhur me biznesin ku figuron si pronar dhe person i autorizuar, ajo është pajtuar me gjendjen, por është arsyetuar se nuk ka qenë i informuar se kjo situatë është në kundërshtim me ligjin në fuqi, si dhe ka deklaruar se biznesi në fjalë nuk zhvillon aktivitet si dhe e ka deklaruar edhe në formularin e deklarimit të pasurisë si biznes pasiv, por është zotuar se brenda afatit ligjor do të bëjë ndryshimet dhe do të veprojë sipas ligjit në fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Pas kësaj shkrese, nga znj. Arta Agani, Drejtoresh e Galerisë Kombëtare të Arteve të Kosovës, kemi pranuar një dokument të lëshuar nga ARBK, ku shihet se znj. Agani, nuk figuron me si person i autorizuar në biznesin me emër N.P. "Gamateli".

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga znj. Arta Agani, Drejtoresh e Galerisë Kombëtare të Arteve të Kosovës, duke u larguar nga funksioni si person i autorizuar në biznesin privatë janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendja e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik për zyrtaren e lartë, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shqip Havolli
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

